



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 4212 Prot

Lezhë, më 29 / 3 /2022

VENDIM

Nr. 27, Datë 23 . 03 .2022

“PËR

**MIRATIMIN E LISTËS SË SUBJEKTEVE PËRFITUESE PËR GRANTE
RINDËRTIMI PËR SHTËPITË INDIVIDUALE DHE BANESA NË NDËRTESA
(PALLATE) ME SHKALLË DËMTIMI DS4 DHE DS5 SIPAS ANALIZAVE TË
THELLUARA TË INSTITUTIT TË NDËRTIMIT NË BASHKINË LEZHË”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”; nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; nenit 3, pika 23, nenit 7, pika 1, nenit 30, nenit 42, pika 1, shkronjat “b” dhe “d” të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”; të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, i ndryshuar; të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”; të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimet njerëzore”; të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.282, datë 09.04.2020 “Për disa ndryshime në vendimin nr.5, datë 06.01.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”; të VKB nr.79, datë 25.06.2020 “Për miratimin e vërtetimit të lëshuar nga Kryetari i Fshatit dhe Administratori i Njësisë Administrative, si dhe dokumentacionit tjetër plotësues, që vertetojnë posedimin dhe gëzimin e vazhduar të banesave, si dhe vërtetimit të legalizimit dhe formularit të aplikimit, si dokumentacion që provojnë pronësinë e objektit për aplikuesit për

programin e rindërtimit”; të VKB nr. 22, datë 14.02.2020 “Për miratimin e manualit për procedurat e përfitimit nga programet e procesit të rindërtimit për strehim”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë, sipas aneksit nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi administrata e Bashkisë Lezhë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI
ERNEST RAKAJ**

